



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborna komisija za žalbe i molbe

A nr. 376/2009

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, në panelin e përbërë nga Osman Tmava, kryesues, Fahredin Ymeri dhe Muharrem Shala, anëtarë, përkitazi me ankesën e Izjah Rexhepit nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD) në Ferizaj, në seancën e mbajtur më datë 14.12.2009, mori

VENDIM

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

ARSYETIMI

Izjah Rexhepi, kandidat për këshilltar në Kuvendin Komunal të Ferizajit nga subjekti politik LDD, ka parashtruar ankesë me të cilën pretendon se në disa vendvotime dyshohet për manipulime.

FAKTET

Më 4 Dhjetor 2009, KZAP ka pranuar një ankesë nga Izjah Rexhepi, kandidat për këshilltar në Kuvendin Komunal të Ferizajit nga subjekti politik LDD.

ANALIZË

Juridiksioni i KZAP për shqyrtimin e ankesës buron nga kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP (Ligji nr – 03/073) dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (Ligji nr 03/L-072).

Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it, Neni 3.4 parasheh si vijon:

3.4 *Përveç nëse nuk është saktësuar ndonjë afat tjetër, ankesa duhet të dorëzohet brenda tri ditëve pas ndodhjes së shkëljes së pretenduar apo brenda tri ditëve pasi që për shkëljen e pretenduar është njoftuar parashtruesi i ankesës ose nga dita kur ai është dashur ta dijë për të.*

KZAP ka pranuar këtë ankesë më datë 4 Dhjetor 2009, gjë që është më shumë se sa tri ditë pasi që shkelja e pretenduar ka pasur mundësi të ndodh. Andaj, KZAP-i vlerëson se Ankesa është e parregullt për faktin se nuk përmban të gjitha elementet e detyrueshme të parashikuara në dispozitat e Nenit 3.4.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitë në Prishtinë

A nr. 376/2009 më datën 14.12.2009

Kryesuesi i Panelit
Osman Tmava

